



Republika e Kosovës
Republika Kosovo/ Republic of Kosovo

Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council

Datë: 27 qershor 2019

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në bazë të nenit 7 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, në bazë të nenit 4 të Rregullores Nr.03/2016 për Transferimin dhe Avancimin e Prokurorëve të Shtetit, dhe në bazë të Vendimit të Këshillit Prokurorial të Kosovës së datës 07 qershor 2019-KPK/Nr. 375/2019, shpall:

RI-SHPALLJE E BRENDSHME

- I. Për plotësim me një (1) pozitë për prokuror në Departamentin për të Mitur të Prokurorisë Themelore në Gjakovë.
- II. Kandidatët e interesuar duhet të plotësojnë këto kritere:
 1. Të kenë mandat të përhershëm;
 2. Të kenë vlerësim pozitiv të performancës;
 3. Të mos kenë të shqiptuar masë disiplinore, përveç qortimit;
 4. Pjesëmarrja në trajnime që ndërlidhet me procedurën penale për të mitur, mjetet juridike, praktikat juridike të gjykatave vendore dhe ndërkombëtare do të merret parasysh.
- III. Kandidati që parashtron kërkesë duhet të dorëzojë edhe dokumentet si në vijim:
 1. Vlerësimi i Kryeprokurorit të prokurorisë përkatëse për tre vitet e fundit;
 2. Çertifikatat e pjesëmarrjes në trajnime;
 3. Dokumente apo të dhëna të tjera relevante ose objektivist të verifikueshme, siç janë ato për njohjen e ndonjë gjuhe të huaj, mësimdhënia në nivel universitar, publikimet shkencore, pjesëmarrja në projekte vendore ose ndërkombëtare si ekspert dhe pjesëmarrja në ekipe hetuese.

- IV. Këshilli Prokurorial i Kosovës inkurajon prokurorët e gjinisë femërore dhe prokurorët nga radhët e komuniteteve jo shumicë që të aplikojnë.
- V. Afati për dorëzimin e kërkesës është nga data 28 qershor 2019 deri më datë 12 korrik 2019.
- VI. Kërkesa duhet të dorëzohet te Koordinatorja për Emërim, Transferim dhe Avancim të Prokurorëve të Shtetit, znj. Ismije Maxhuni, në katin e katërt (4) të ish ndërtesës së EULEX-it, rruga Luan Haradinaj - Prishtinë, zyra numër 413, të mbyllura në zarf, ose me postë.